



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Opstina Istok
Istog Municipality

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

DATË/A:	01.12.2022
REFERENCË:	01/DM/2022
PËR/ZA/TO:	Të gjithë anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi
CC:	Jerej Nebojsa Sekulliq, Kisha Ortodokse
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	z. Ilir Ferati, Kryetar
TEMA/SUBJEKTA/SUBJECT:	Komunikat për medija
VENDI/MJESTO/PLACE	



Deklarata publike e komunës për dënimin e incidentit

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) në mbledhjen e mbajtur me datë 30.11.2022 duke shqyrtuar "Siguria në zonën e përgjithëshme të Policisë së Kosovës, gjegjësisht në Komunën e Istogut, nga Komandanti i Stacionit të policisë si dhe nga vetë përfaqësuesi i kishës Ortodokse jerej Nebojsa Sekulliq janë njoftuar se ka ndodhur një incident, hedhja e gurve në objektin e banimit në oborrin e kishës ortodokse në qendren e qytetit Istog.

Jerej Nebojsa Sekulliq e thekson se ka tetë vite që banon në Istog dhe se deri me tani nuk ka pas asnjë problem në objektin e Kishes dhe as në hapsirat tjera publike të qytetit të Istogut.

Antarët e KKSBB-së e gjykojnë rastin të pa prënueshëm për shoqërinë tonë, për mardhënjet nderfetare dhe kërkojnë nga organet e sigurisë zbardhjen e rastit dhe ngritjen e vigjilencës në të ardhmen për parandalimin e akteve të tilla.

Me respekt!